



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Data 22 / 08 / 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar Llazar Kuli-Perondi + ndërtim ambjente ndihmëse”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi **45214200-2** (punime ndërtimi për shkolla)

VLERA E FONDIT LIMIT :

67 091 772,5 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy presje pesë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
- c. Formularin e ofertes sipas shtojcës 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26 dhe 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, si dhe për vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “PërSistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurattatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.

9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
 - b) **vlerën e përlllogariturtë të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
 - c) 40 % të vlerës së përlllogariturtë të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.
-

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"**.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale :

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- d) Akt Kolaudimi*
- e) Faturat tatimore*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
- d) Akti i Kolaudimit*
- e) Faturat tatimore,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P - 2 A** Ndërtime civile dhe industriale;
- **N.P - 3 B** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash;
- **N.P-12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit;

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S -4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S - 12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike;
- **N.S - 19 A** Sistemet kundër zhurmës për infrastrukture;

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave te kerkuara jane bazuar ne Lidhjen 2,3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

KAT	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Nr. An	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1	Punime gërmimi në tokë	3.87/b	Germim dheu kanal me makineri L=115 ml B=1 m H = 0.8 m	Niveli A
		2.1	Germim dheu me krah e transport deri 10 m per bordure	
		3.87/a	Germim dheu me makineri kat III per sheshet	
		3.497	Germim dheu bazament shtylle	
		2.1	Germim dheu themel muri L =164	
		2.28/a	Germim dheu themeli me makine + transport	
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Përfshihet ndërtimi i ambjenteve ndihmëse që do ti shtohen godinës ekzistuese që do të rikonstruktohet totalisht		Niveli A
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje	Rikonstruksioni i plotë i godinës ekzistuese ku përfshihet shtrimi me pllaka dhe parket, suvatim i		Niveli B

	godinash civile e industriale, veshje fasada	brendshem dhe i jashtëm, termoizolimi i godinës, veshje fasade, dyert dhe dritaret e reja, çatia e re, sistemi elektrik nga e para, sistemi ngrohjes nga e para etj.		
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	An	Mbushje me dhe për lulishten t = 20 cm	Niveli A
		3.643	Mbjellje bari	
		An	F V stola	
		An164	F.V. Fidane Peme dekorative	
		An	FV porta + rrjete basketbolli + beton per ink	
		An	FV tabele + rrjete volejbolli	
		An146	Boje termoplastike (paste) per vijezimet e fushave sportive	
		2.413	F V zgara dekorative me figuracion mesatar per rrethim muri (profil 2 x 1 cm , sigma 1 mm)	
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	2.426/3	Prishje shtresa betoni dyshemeje t = 10 cm	Niveli A
		2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	
		Analize	Prishje suvaje t=3-4 cm h=3.05 m , 3.15 m	
		Analize	Heqje dyer dritare	
		Analize	Cmontim - heqje ulluqesh horizontale e vertikale	
		Analize	Heqje pllaka muri ne vertikalitet (nyjet sanitare)	
		Analize	Heqje pllaka ne dysheme	
		Analize	Prishje suvatim i jashtem t= 5cm	
		Analize	Heqje shtrese hidroizolim dhe nenshtresat + transport mbeturinash 5 km (tarraca)	
		Analize	Cmontim i rrjetit elektrik ekzistues	
		Analize	Cmontim i nyjeve hidrosanitare	
		2.37/5b	Transport mbeturina ndertimi, dheu deri 10 km	
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	2.501	F V WC allaFrenga importi + kasete WC	Niveli A
		2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	
		2.491/a	F V tuba e rakorderi plastike PPR d= 20-25mm PN 25 mm	
		2.515	F V pilete dyshemeje Ø 50 mm	
		2.52	F V tub PVC 110 mm per shkarkim	
		2.516/1	F v tuba e rakorderi PVC per shkarkimet	

	paiisjeve	
An-22	Ndertim pusete shkarkimi 80x80cm H = 1 m + kapak betoni	
3.An/1t	F.V. tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315mm	
An	F.V. Kabell elektrik bakri FROR 3x1.5	
An	F.V. Kabell antizjarr grade III 2x0.8 i kuq	
2.487	F.V. Kuti derivacioni plastike	
2.480/1	F.V. Tub plastmasi Ø14-17mm	
2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø18-21mm	
An	F.V. Sensor termik tymi temperature	
An	F.V. Sirene alarmi brenda ndertes	
An	F.V. Sirene alarmi jashte ndertes	
An	Panel konvencional kontrolli me 2 zona	
An.1.5	F.V Buton alarmi	
An.1.6	F.V Tabela drejtim dalje	
An.1.7	F.V Tabela hidranti	
An.1.8	F.V Tabela Zbritje shkallesh	
An.1.9	F.V Tabela buton alarmi	
An.1.10	F.V Tabele fikse zjarri me pluhur	
An.V.1.11	F V. Kaset + hidrant zjarri i brendshem. Kase brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyre te kuqer RAL 3000 - UNI 9227,me baze rezine. Dimensionet (370x610x190)mm, tub fleksibel 30 m, Aksesoret: saraqineske nderprerese 1½", lançe + zorre uji DN 45. Pjesa e perparme e mbyllur me çeles.	
An.V.1.12	F V. Fikse zjarr me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm.	
An.V.1.13	F V. Grupi i lidhjes me motopompen per hidrant DN70. Vendosija ne kase te jashtme, llamarine çeliku te emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.	
An.V.1.14	F V. Pompa e furnizimit me uje te hidranteve, Karakteristikat Teknike: - Prurja: 7.2 m ³ / h - Prevalenca: 40 mkH ₂ O - Lidhjet: Ø 2 1/2" / PN 10 - Fuqia elektrike 5.5kW -3-400v/50Hz	

NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	2.64/1	Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3 m llac M-15	Niveli B
		2.262	Shtrese betoni C 6/10 t = 10 cm	
		2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 (parvazet e shkalleve,rampat e shkalleve dhe dritaret)	
		2.195	Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum (kati perdhe)	
		2.196/c	Hidroizolim ne nyje sanitare me dy shtresa mapej	
		2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	
		2.267/1	Shtrese me pllaka grez porcelanato ne klasa, laboratore, zyra ngjitur me kolle	
		2.276	Shtrese parketi druri	
		2.273/4	Shtrese me pllake mermeri t=2cm Janina dritare+shkalle dhe sheshpushime	
		2.326	Veshje me pllake majolike	
		2.31	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	
		2.297/a	Tavan me kartonxhes	
		Analize	Veshje fasade me polisterol t=7cm zjarrdurues + rrjete + suva	
		2.308a	Suvatim me grafiato h > 4 m	
		2.348	Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me çokitje	
		2.324/2	Plintus me pllaka mermeri ne shkalle	
		2.324/b	Plintuse grez importi, h = 10 cm	
		Analize	F + V shirit MDF ne muret e klasave a=15cm, ne lartesine e bankave	
		2.375/1	Dritare duralumini plastike dopio xham	
		2.373/1	F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham	
		2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a. (Tualetet)	
		2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I	
		Analize	F V dyer emergjence me brave antipanik	
		2.404/1	Boje hidroplastike cilesia 1 (muret e suvatuara dhe tavanet me kartonxhes)	
		2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi 1 fasade	
		2.262/4	Shtrese betoni C16/20 per soleten t = 10 cm	
		Analize	Shtrese termoizoluese me polesterol t=5 cm	

	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama
	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2
	2.279	Shtrese derrasa FM 2.5cm
	Analize	FV membrane ajrosese dhe hidroizoluese per cati
	2.218	Ndertim cati Hd ~ 8 m e zakonshme me tjegulla vendi
	2.209/b	Ulluk shkarkimi Vertikal bakri Ø 120 mm
	2.212/b	Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33 cm
	2.206/b	Kasete shkarkimi bakri per ullukun t = 1 mm
	2.110/2	Themel + xokol butobetoni C12/15 L = 164 ml
	An	F v porte metalike dekorative rreshqitese
	2.401	Boje vaji sipërfaqe metalike

NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	2492	F.V tuba xingato 2'	Niveli A
		2492	F.V tubo xingato 0 1½"	
		2491	F.V tuba xingato 0 ½"	
		2.535/g	F.V termoizolim tubi 02" me amofleks 0 64x9	
		2.535/g	F.V Armafleks 1½" me amofleks 0 54x9 mm	
		2.535/a	F.V Armafleks ½" diameter I brendshem 022	
		2.512/6	F.V Kolektor shperndares 1¼" 8 dalje 1½"	
		2.494/3	F.V Saracineska sferike Bronzi me buketon 1¼"	
		An.Tek.	F.V Adaptues per tuba multistrade 0 32-1¼"	
		An.Tek.	F.V Adaptues per tuba multistrade 0 16-½"	
		An.Tek.	F.V Tuba multistrade e termoizoluar Pe-X 16x2	
		An.Tek.	F.V Radiator alumini me 10 element.Distanca nderaksiale 600mm	
		An.Tek.	F.V KALDAJE GAZI + BRUCATOR 110 Kw (e pavarur per cdo kat)	

		Analize	F.V Rezervuari i gazit Depozitë horizontale dopio paret - Kapaciteti 2000 lit;	
		4/167	F.V Valvule sigurimi ¾" 3 bar	
		4/168	F.V Valvule ajernxjerresi (cajrues)½"	
		4/169	F.V Ene zgjerimi me diafragme fikse 80 lit+	
		2494	F.V Ventila me leve Pg 16 Dg½" =20mm	
		2.494/4	F.V Ventila me leve Pg 16 Dg½" =40mm	
		2,494/4	F.V Valvule moskthimi Pg 16 Dg½" =40mm	
		2.494	F.V Valvule moskthimi Pg 16 Dg½" =20mm	
		2.494	F.V Filter mekanik Pg 16 Dg½" =20mm	
		2.494	F.V Filter antikalkarPg 16 Dg½" =20mm	
		2,494/4	F.V Filtermekanik Pg 16 Dg½" =40mm	
		An.Tek.	F.V Termometer (0-120°C)	
		An.Tek.	F.V Manometer (0-5) bar	
		An.Tek.	F.V Grupi I mbushjes automatike me uje te sistemit	
		An.Tek.	F.V OXHAK Ø 200mm llamarine	
		An.Tek.	F.V Pompe qarkullimi Prurja 110l/minpresion	
		An.Tek.	F.V Termostat ambjenti	
		An	F.V Sistem panele diellore per prodhimin e ujit te ngrohte sanitar, e tipit me pasqyra, siperfaqe absorbuese, pressioni i punes 6 bar	
NS-14	Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	2.490/h	F V kasete plastike KE me 54 vende	Niveli A
		2.490/f	F V kasete plastike KE me 36 vende	
		2.a-107	Automat magneto termik 380V 63A 4P	
		2.490/2	F V Automat termo/el magnetik 2P 220V 16A dI=0.03A	
		2.490/2	F V Automat termo/el magnetik 2P 220V 20A dI=0.03A	
		2.490/2	F V Automat termo/el magnetik 2P 220V 25A dI=0.03A	
		2.a-108	Automat magneto termik 380V 25A 4P	
		2.490/1a	F V Automat termo/el magnetik 2P 220V 10A	

2.490/1b	F V Automat termo/el magnetik 2P 220V 16A
2.a-120	Llambe sinjali
480/1	F V tub plastmasi Φ 16mm
480/2	F V tub plastmasi Φ 20mm
480/3	F V tub plastmasi Φ 25mm
2.481/1	F.v percjelles Φ 1.5 mm blu
2.481/1	F.v percjelles Φ 1.5 mm kaf
2.481/1	F.v percjelles Φ 1.5 mm zeze
2.481/1	F.v percjelles Φ 1.5 mm zeze
2.481/2	F.v percjelles Φ 2.5 mm blu
2.481/2	F.v percjelles Φ 2.5 mm kaf
2.481/2	F.v percjelles Φ 2.5 mm verdhe/jeshil
2.481/3	F.v percjelles Φ 4 mm blu
2.481/3	F.v percjelles Φ 4 mm kaf
2.481/3	F.v percjelles Φ 4 mm verdhe/jeshil
2.481/5	F.v percjelles Φ 10 mm blu
2.481/5	F.v percjelles Φ 10 mm kaf
2.481/5	F.v percjelles Φ 10 mm gri
2.481/5	F.v percjelles Φ 10 mm zi
2.481/5	F.v percjelles Φ 10 mm verdhe/jeshil
2.487	F V kuti derivacioni plastike
2.a-137	Ndricues floureshent 4x18W IP44
2.a127	Ndricues floureshent 2x36W IP44
2.a-135	Ndricues tip spot 2x18W
2.487/d	F.v kuti suport pllaket 4 modular Gevis
2.485/2	F V celes 1 polar 220V 10A Gevis
2.485/d	F V priza shuko Gevis universal
2.485/b	F V priza bivalente 220V 10A 2P+T Gevis
An	DVR 8ch h426 web server ddns 3g gprs ip
An	Hard disk 1000 gb sata II SAGATE
An	Kabell video rg59+ 2 x0.5 mm gri coax 750 hm 6 mm gri
An	Suich me 24 porta + 1 fiber optike
An	Fibra optike
An	Kabell interneti
2.483	Prize interneti
An	F v kamera 700 tvl fokus 2.8 - 12 mm ip65
An -34e	FV Monitor 21" me ngjyra per sistemin CCTV

	An -35e	FV Rack 22 HU, 80x80cm	
	An -33e	FV Video regjistrator dixhital NVR, kapaciteti min 6TB	
	4.131/3.9	Kabell CU fuqie xlpe 3x50 + 25mm ²	
	3.An/et	F.v elektroda tokezimi te xinguara profil; l=150m (mbrojtja atmosferike)	
	2.a-98	Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm	
	3.An/53	F.V. Shtylla metalike per ndricim H = 7 m d = 160 mm	
	3.An	Ndricues Smart 250 W , 230 V	
	480/5	F.V. Tubo fleksibel ø63mm	
	2.a-107	Automat magneto termik 380V 63A 4P	
	An	F.V. Kabell 4x6mm	
	An	F.V. Kasete metalike	
	3.An/pp	F.V. Pusete plastike 40x40cm	
	2.a-74	F.V. Tokezim shtyllash	
NS-18	2.1	Germim dheu dheu me krah e transport me dore	Niveli A
	3.87/b	Germim dheu kanal me makineri L=115 ml B=1 m H = 0.8 m	
	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm nen tub	
	3.353	Mbulim kanali me cakell	
	2.1	Germim dheu me krah e transport deri 10 m per bordure	
	3.87/a	Germim dheu me makineri kat III per sheshet	
	2.262	Shtrese betoni nen bordure	
	3.617	F.V. bordure betoni 0.15x0.25	
	2.288	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit	
	3.226/4	Shtrese asfaltbetoni me ngjyre me granil guri t = 7 cm (per fushat basketboll + volejball)	
	3.211	Shtrese Cakelli t = 20 cm perhapur e ngjeshur me makineri	
	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10 cm	
	2.1	Germim dheu themel muri L =164	
	2.110/2	Themel + xokol butobetoni C12/15 L =	
	Punime topogjeodezike		

			164 ml	
NS-19	Sistemet kundra zhurmës për infrastrukture	2.297/a	Tavan me kartonxhes	Niveli A
		Analize	Veshje fasade me polisterol t=7cm zjarrdurues + rrjete + suva	
		2.375/1	Dritare duralumini plastike dopio xham	
		2.373/1	F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham	
		2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a. (Tualetet)	
		2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I	
		Analize	Shtrese termoizoluese me polesterol t=5 cm	

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme (sipas Lidhjes 3)

- Kategoria NP-1 A (Punime gjermimi në tokë)

Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë gjermimet për themelet e godinës shtesë, gjermim për kanalizimet KUZ të shkollës, gjermime dhe sisteme të ndryshme të shesheve përpara shkollës për ndërtimin e terreneve sportive dhe shkallën e emergjencës, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NP-2 A (Ndërtime civile dhe Industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë ndërtimin nga e para të ambjenteve shtesë ndihmëse, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NP-3 B (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë rikonstruksionin total të objektit, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë per keto punime. (Për shkak se mbledha e shumatores për punime të sipërcituara është mbi 21 milion lekë).

- Kategoria NP-12 A (Punime të inxhinierisë së Mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimi të kompaktësimi të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zërave të preventivit kemi të bëjmë me punime gjelbërimi si mbjellje bari dhe pemësh dekorative, vendosje stolash dekorativ, rrethimi me zgara hekuri me figuracion dekorativ, dhe punime gjermimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin perreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmerie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

Konsiderohet çmontimi i impianteve industrial dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhericiklimin e materialeve.

Referuar zërave të preventivit për punimet dhe prishjen e ndërtimeve nga brenda dhe jashtë ndërtesës, gjatë të cilave kryhen punime prishje, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse. Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji. Kemi prishje të elementeve të godinës si: prishje murature, prishja e dysHEMEVE, prishja e veshjeve me pllaka të mureve, heqja e dyerve dhe dritareve, çmontimi i rrjetit ekzistues elektrik dhe hidraulik. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-2 A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e

muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë punimet për nyjet sanitare, furnizimin e pajisjeve hidrosanitare, impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-4 B (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë të gjithë zërat e përmendur më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime për shkak se vlera e tyre, është në kufirin e përcaktuar më sipër.

- Kategoria NS-12 A (Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit)

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve të cilat përfshijnë komplet implementimi i sistemit të ngrohjes së bashku me kaldajen dhe aksesoret përkatës, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-14 A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me

muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi I sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zërave të preventivit dhe sasisë së punimeve, ku përfshihen punimet e pajisjet elektrike, si dhe rrjeti i telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit dhe sistemin e kamerave, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

- Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime specialegeodezike; rrjeta

Në këtë objekt përfshihen edhe punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave te kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS – 19 A (Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë)

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

Në këtë objekt parashikohen të kryhen punime si vendosja e dritareve me duroplast termik, tavanet me kartonxhes, vendosja e polisterolit në çati, të cilat bëjnë të mundur një izolim akustik me optimal. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi Profili Konstruktor/Strukturist	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

- Kontratë punë noteriale e vlefshme
- Diploma

Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me :

- Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Strukturist/Konstruktor** kërkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet nga e para, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv përse i përket trarëve dhe kollonave b/arme dhe hekur, soletave, strukturës metalike të shkallës së emergjencës, dhe murit rrethues me beton dhe hekur.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku përfshihet komplet sistemi i ngrohjes dhe sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit MNZ sipas parashikimeve në projektin mekanik.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime elektrike, do të kemi ndryshime linjash elektrike dhe ndryshim ndriçimi në të gjithë ambientet e objektit të ri, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjatë periudhës të zbatimit të punimeve.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e tubave dhe rakorderive, pajisjeve hidrosanitare (WC, lavaman, rubineteri etj), furnizimin e ujit sanitar, sistemin MNZ, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rlevime të ndryshme topografike në sisteme

koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme, persa i perket sistemit të terreneve të jashtme.

- **Inxhinieri i Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit ku kemi të bëjmë me punime të jashtme dhe gjelbërimi si mbjellje bari dhe pemësh dekorative, vendosje stolash dekorativ, rrethimi me zgara hekuri me figuracion dekorativ, dhe punime gërmimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.

Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me :

- Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka lëshuar kete dokument.*

Argumentimi: Duke qenë se një pjesë të konsiderueshme të punimeve mekanike e zë sistemi i ngrohjes, është e domosdoshme që Drejtuesi Teknik që do të ndjekë këto procese të jetë i specializuar dhe i profilizuar përsa i përket kondicionimit dhe sistemeve ngrohje-ftohje, pasi gama e profilit të inxhinierëve mekanik është e larmishme dhe nuk kufizohet vetëm tek sistemet HVAC, por edhe tek industritë prodhuese, automekanika, makineritë lëvizëse etj.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) si dhe të jenë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, si më poshtë:

- Inxhinier Telekomunikacioni/IT/Elektronik 1 (një)
- Punonjës të pajisur me “Certifikatë e Audituesit Energjistik” 1 (një)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten :

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma

Përsa i përket Inxhinierit Telekomunikacion/IT/Elektronik duhet të jetë i pajisur me :

- Certifikatë për “CCNA Routing and Switching” ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **Inxhinier Telekomunikacioni/IT/Elektronik** është i nevojshem gjatë zbatimit pasi referuar preventivit nuk kemi vetëm instalimet elektrike por edhe instalimin e rrjetit të telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit dhe sistemin e kamerave CCTV, si vijon: (DVR 8ch h426 web server ddns 3g gprs ip); (Hard disk 1000 gb sata II SAGATE); (Kabell video rg59+ 2 x0.5 mm gri coax 750 hm 6 mm gri); (Suich me 24 porta + 1 fiber optike); (Fibra optike); (Kabell internet); (Prize interneti); (F v kamera 700 tvl fokus 2.8 - 12 mm ip65); (FV Monitor 21" me ngjyra për sistemin CCTV); (FV Rack 22 HU, 80x80cm); (FV Video regjistrator dixhital NVR, kapaciteti min 6TB) etj. Referuar këtyre zërave është e rëndësishme të disponohet ndjekja dhe ekspertiza e një Inxhinieri Elektronik/IT/Telekomunikacioni.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Kjo certifikatë kërkohet kur ka punime në rrjetin e internetit, rrjetin IT, punimet e telefonisë, drejtimi, lidhja dhe konfigurimi i këtyre rrjeteve. Më konkretisht nëpërmjet këtij kualifikimi vërtetohen njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të instaluar, konfiguruar, operuar dhe zgjidhur një rrjet ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme, siç kërkohet dhe në preventivin e punimeve.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme prania e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

- **Përsa i përket punonjësit të pajisur me** “Certifikatë e Audituesit Energjistik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës e) është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për eficiencyn e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen :

- çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”, si dhe bazuar në VKM nr. 407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet Certifikata e Audituesit Energjetik”, ku parashikohet se: a) “Certifikatë e audituesit energjetik”, certifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficiencyn e Energjisë (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri.

Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime të cilat lidhen me eficiencyn e energjisë si sistemi i ngrohjes, qarkullimi i ajrit, izolimi akustik, hidrik dhe termik jemi në kushtet që disponueshmëria e një auditesi energjie në bazë të VKM Nr. 407 datë 19.06.2019, është i domosdoshëm.

Për objektin konkret, në fazën e projektimit nuk është hartuar raporti paraprak i eficiencys së energjisë dhe rrjedhimisht është i domosdoshëm Audituesi i Energjisë në fazën e zbatimit.

- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Gjeoteknik** është i nevojshëm pasi ai do të verifikojë në terren kapacitetet mbajtëse të tokës dhe lidhjen e saj me tipin e zgjedhur të themelit dhe implementimin e plintave, përta i përket ndërtimit të godinës shtesë. Inxhinieri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karrierave të materialeve që do të përdoren për nënshtresë zhavori, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për plintat e themelit dhe për materialet e betoneve te tjera. Projekti zbatohet mbi formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e inxhinierit të sipërcituar. Bazuar në hartën e re sizmike ku i gjithë territori i Shqipërisë konsiderohet me sizmicitet të lartë, kujdesi dhe nevoja për staf të kualifikuar aq më tepër për stafin tekniko – inxhinierik si Inxhinieri Gjeoteknik është evidente. Pasi bëhet inspektimi në vend si dhe provat laboratorike, i propozohen mbikqyrësit të punimeve Mix – Design e Betoneve. Një rëndësi të madhe do të ketë prezenca e Ing. Gjeoteknik gjatë ndërtimit të shtresave nën-asfalt të terreneve dhe themeleve të rrethimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	
1	Teknik të mesëm ndërtimi	(2 persona)
2	Teknik të mesëm mekanik	(1 person)
3	Teknik të mesëm topograf /gjeodet / gjeometer	(1 person)
4	Teknik të mesëm elektrik	(1 person)
5	Karpentier	(2 persona)
6	Hekurkthyes	(1 persona)
7	Hekurpunues	(1 person)
8	Murator/Suvatues	(4 persona)
9	Pllakashtrues	(3 persona)
10	Hidroizolues	(2 persona)
11	Termoizolues	(1 person)
12	Specialist parketi	(1 person)
13	Specialist për veshje fasade	(2 persona)
14	Bojaxhinj	(4 persona)
15	Saldator	(2 persona)
16	Përgatitës të konstruksioneve metalike	(1 person)
17	Elektricitist	(3 persona)
18	Hidraulik	(2 persona)
19	Specialist gipsi	(3 persona)
20	Marangoz/Mobilier	(2 persona)
21	Specialist asfalti	(2 persona)
22	Specialist për sisteme ngrohje-ftohje	(3 persona)
23	Teknik të mesëm/specialist elektronik/IT	(1 person)
	Totali 45 (dyzetë e pesë) punonjës	

Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;

- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (çertifikatë/dëshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”

(Per teknikët e mesëm duhet të paraqitet diploma ose dëftesa e përfundimit të shkollës së mesme profesionale).

- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesat e gërmës c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i Mesëm Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kërkesa e AK për 2 (dy) Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti i prokurimit do të jetë i shtrirë në dy fronte njëkohësisht (rikonstruksioni dhe shtesa e godinës dhe sistemimet e jashtme), dhe për këtë arsye duhet prania e dy punonjësve të tillë.
- **Tekniku Mesëm Mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen e zbatimin e projektit mekanik, për realizimin e sistemit të ngrohjes, sistemin MNZ dhe furnizimin me ujë të ngrohte.
- **Tekniku i mesëm topograf /gjeodet / gjeometer** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemit të jashtëm, sepse kemi punime të cilat kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara ku duhen montuar strukturat apo elementet e ndryshëm dhe ata duhet të lexojnë projektin dhe kryejnë matjet e nevojshme.
- **Tekniku Mesëm Elektrik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

- **Karpentier 2 (dy)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik ndërtimi, montimi i skelave për punimet në lartësi etj.

Duke qënë se shkolla ka sipërfaqje të madhe ndërtimi, si dhe ambjenti i ri ndihmës që do të ndërtohet dhe konkretisht 590 m², ku gjatësia e objektit është 41.3 m, gjerësia është 14.3 m dhe ku lartësia e objektit është 6.6 m (2 kate).

Në bazë të të dhënave të mësipërme, del sipërfaqja e të katër anët e objektit.

41.3m (gjatësia) x 6.6m (lartësia) = 272.58 m² (sipërfaqja e një anë) x 2 = 545.16 m² (për sipërfaqjen e dy anëve).

14.3 m (gjerësia) x 6.6m (lartësia) = 94.38 (sipërfaqja e një anë) x 2 = 188.76 m² (për sipërfaqjen e dy anëve).

545.16 m² + 188.76 = 733.92 m² (sipërfaqja totale e katër anët e objektit).

Nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 2 (dy) karpentierëve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Hekurkthyes 1 (një)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit.
- **Hekurpunues 1 (një)** është i nevojshëm për rrahjen dhe punimin e hekurit për realizimin e zgarave dekorative me figuracion mesatar për rrethim muri.
- **Murator/Suvatues 4 (katër)** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të muraturës dhe suvatimeve në tavan dhe mure sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, për rikonstruksionin e shkollës janë parashikuar punime të cilat kërkohet domosdoshmërisht prania e pllakashtruesve.

Në seksionin I. PUNIME MURATURE

2.64/1 Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3 m llac M-15 në sasinë 10 m³, rreth 110 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin III. PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

2.310 Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 në sasinë 1,715 m², rreth 1,329.13 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.308a Suvatim me grafiato h > 4 m në sasinë 537 m², rreth 1,879.50 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.348 Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me çokitje në sasinë 52 m², rreth 395.20 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Për ambjentin ndihmës

Në seksionin I. PUNIME MURATURE

2.64/1 Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3 m llac M-15 në sasinë 70 m³, rreth 770 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin III. PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

2.310 Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 në sasinë 524.5 m², rreth 406.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.308a Suvatim me grafiato h > 4 m në sasinë 210 m², rreth 1,218 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.348 Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me çokitje në sasinë 14.2 m², rreth 107.9 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 6216.23 orë pune gjithsej për punime që nevojitet domosdoshmërisht prania e muratorit/suvatuesit.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e

Duke qënë se punimet e muraturës dhe suvatimeve në tavan janë në volume të mëdha si më sipër listuar, duke u bazuar edhe në grafikun e punimeve ku përcaktohen punimet e mësipërme për gjatë gjithë afatit të zbatimit të saj si për rikonstruksionin e shkollës ashtu edhe për ambjentin ndihmës, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 6216.23 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 4 (katër) punonjës **Murator/Suvatues**.

- **Pllakashtrues 3 (tre)** janë të nevojshëm për shtrimet e dyshemeve me pllaka graniti, mermeri, qeramike dhe porcelani, si dhe veshjen e tualeteve me pllaka qeramike.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, për rikonstruksionin e shkollës janë parashikuar punime të cilat kërkohet domosdoshmërisht prania e pllakashtruesve.

Në seksionin II. për Punime shtresash janë parashikuar punime si :

2.267/1 Shtrese me pllaka grez porcelanato ne klasa, laboratore, zyra ngjitur me kolle në sasinë 735 m², rreth 1,470 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.273/4 Shtrese me pllake mermeri t=2cm Janina dritare+shkalle dhe sheshpushime në sasinë 53 m², rreth 165.4 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin III. Për punime suvatimi dhe veshje janë parashikuar punime si :

2.326 Veshje me pllake majolike në sasinë 82 m², rreth 303.4 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.324/2 Plintus me pllaka mermeri ne shkalle në sasinë 45 ml, rreth 15.75 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.324/b Plintuse grez importi, h = 10 cm ne shkalle në sasinë 602 ml, rreth 210.7 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Për ambjentin ndihmës

Në seksionin II. Për punime shtresash janë parashikuar punime si :

2.273/4 Shtrese me pllake mermeri t=2cm Janina dritare në sasinë 3.6 m², rreth 11.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.267/b Shtrese me pllaka grez porcelanato importi në sasinë 190 m², rreth 319.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin III. Për punime suvatimi dhe veshje

2.324/2 Plintus me pllaka mermeri ne shkalle në sasinë 10 ml, rreth 3.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.324/b Plintuse grez importi, h = 10 cm në sasinë 136 ml, rreth 47.6 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin 11- për punime shesheve para shkollës

2.288 Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit në sasinë 1301 m², rreth 3122.4orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 5669.15 orë pune gjithsej për punime të cilët nevojitet prania e pllakashtruesve.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për shtrimin e pllakave graniti, mermeri, qeramike dhe porcelani, si dhe veshjen e tualeteve me pllaka qeramike mund të kryhen edhe gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve për rikonstruksionin e shkollës dhe për amjentin ndihmës, duke u bazuar edhe në grafikun e punimeve ku përcaktohen punimet e mësipërme për gjatë gjithë afatit të zbatimit të saj, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 5669.15 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) punonjës pllakashtrues.

- **Hidroizolues 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hidro-izolimit në dysHEME dhe nyjet sanitare, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, në seksionin II punime shtresash për rikonstruksionin e shkollës, është parashikuar zëri 2.195 Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum (kati përdhe) në sasinë 437 m², rreth 183.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe zëri 2.196/c Hidroizolim në nyje sanitare me dy shtresa mapej në sasinë 82 m², rreth 53.3 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin VI punime çatie dhe tarrace, është parashikuar zëri 2.196/c Hidroizolim me 2 shtresa mapei + rrjete per tualetet në sasinë 99.8 m², rreth 41.9 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

FV membrane ajrosese dhe hidroizoluese per cati në sasinë 665 m², rreth 66.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe për ambjentin ndihmës, për punime shtresash janë parashikuar punime 2.196/c Hidroizolim me 2 shtresa mapei + rrjete per tualetet në sasinë 22 m², rreth 14.3 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin VI të preventivit për punime çatie dhe tarrace është parashikuar për ambjentin ndihmës 2.196 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama në sasinë 99.8 m², rreth 41.9 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1), dhe FV membrane ajrosese dhe hidroizoluese për çati në sasinë 150 m², rreth 15 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 401.4 orë pune gjithsej për punime hidroizolimi.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për hidroizolim do të kryhen për 1 (një) muaj (sipas grafikut të punimeve) për rikonstruksionin e shkollës dhe për amjentin ndihmës, atëherë nevojiten 208 orë pune.

401.4 orë pune (për punimet hidroizolimi) : 208 orë totali për 1 (një) muaj = 1.9 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës hidroizolues.

- **Termoizolues 1 (një)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termoizolimit si vendosja e shtresës termoizoluese në çati.
- **Specialiste parketi 1 (një)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të dyshemesë me parket druri.
- **Specialist për veshje fasade 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të veshjes së fasadës me polisterol për termoizolim e objektit.

Konkretisht, për rikonstruksionin e shkollës në zërin e preventivit tek seksioni VI punime çatie dhe tarrace Shtresë termoizoluese me polesterol t=5 cm në sasinë 665 m², rreth 897.8 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe të njëjtat zëra si më sipër, do të kryhen për ambjentin e ri ndihmës që do të ndërtohet nga e para, dhe konkretisht :

Shtresë termoizoluese me polesterol t=5 cm në sasinë 99.8 m², rreth 134.7 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 1 032.5 orë pune gjithsej për punime fasade.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për fasadën do të kryhen për 1 (një) muaj për rikonstruksionin e shkollës dhe 1 muaj për amjentin ndihmës, atëherë nevojiten 416 orë pune.

1 032.5 orë pune (për punimet fasade) : 416 orë totali për 2 (dy) muaj = 2.4 punonjës specialist për veshje fasade të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës Specialist për veshje fasade.

- **Bojaxhinj 4 (katër)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të lysterjeve të brendshme dhe fasadës, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e lysterjes së shkollës + ambjentit ndihmës nuk mund të kryhet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës (e cila është 4 muaj) për shkak se është procesi i fundit që kryhet në përfundimin e një rikonstruksioni, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish bojaxhinj. (sipas grafikut të punimeve) ky proces është bashkëngjitur me proceset e tjera të ndërtimit, ku gjithsej sipas grafikut është parashikuar që të gjitha proceset e punës do të kryhen në 9 javë, si punime ndërtimi, punime murature, punime shtresash, punime suvatimi dhe veshje, punime dritare dhe dyer, si dhe punime bojatisje. Duke ndarë proceset e punës, njësia e prokurimit gjykon se punimet për bojatisje nuk mund të zgjasin më shumë se 1 muaj e gjys, dhe për rrjedhojë llogaritja e numrit të punonjësve nga AK për bojaxhinj është bërë për këtë periudhë kohe të sipërcituar.

Konkretisht, në seksionin V Punime Bojatisje janë parashikuar punime lysterje tek preventivi i punimeve zëri me nr 32 dhe 33, me nr anal 2.404/1 Bojë hidroplastike cilësia 1 (muret e suvatuara dhe tavanet me kartonxhes) në sasinë 2450 m², rreth 882 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1), si dhe me nr anal 2.404/1 Bojë hidroplastike importi cilësi 1 fasade në sasinë 537 m², rreth 193.3 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 1075.3 orë pune për lysterjen e shkollës.

Si dhe të njëjtat zëra si më sipër, do të kryhen për ambjentin e ri ndihmës që do të ndërtohet nga e para, dhe konkretisht :

Në seksionin V Punime Bojatisje janë parashikuar punime lysterje tek preventivi i punimeve zëri me nr 146 dhe 147, me nr anal 2.404/1 Bojë hidroplastike cilësia 1 (muret e suvatuara dhe tavanet me kartonxhes) në sasinë 714.5 m², rreth 257.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1), si dhe me nr anal 2.404/1 Bojë hidroplastike importi cilësi 1 fasade në sasinë 210 m², rreth 75.6 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 332.8 orë pune për lysterjen ambjentin e ri ndihmës.

Nga mbledhja e orëve të punës për lysterjen e shkollës dhe të ambjentin të ri ndihmës, në total janë 1408.1 orë pune për përfundimin e punimeve me sukses.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për lysterje do të kryhen për 1 (një) muaj e gjys, atëherë nevojiten 312 orë pune.

1408.1 orë pune (për punimet lysterje/bojatisje) : 312 orë totali për 1 (një) muaj e gjys = 4.5 punonjës bojaxhinj të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 4 (katër) punonjës bojaxhinj.

- **Saldator 2 (dy)** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Përgatitës të konstruksioneve metalike 1 (një)** është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik, në konstruksione prej metali si shkalla e emergjencës.
- **Elektricitist 3 (tre)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet elektrike do të kryhen në muajin e tretë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish elektrik.

Konkretisht, vetëm për muajin e tretë janë parashikuar punime elektrike 1209.1 orë punë nga zëri nr 48 deri 83 tek preventivi i punimeve (sipas tabelës nr 1).

Dhe nga zëri Nr 165 – 182 tek preventivi (sipas tabelës nr 1) janë parashikuar rreth 607.7 orë pune.

Duke marrë në konsideratë dhe Cmontimin e rrjetit elektrik ekzistues rreth 120 orë pune, në total janë 2016.8 orë pune për punime elektrike.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

2016.8 orë pune (për punimet elektrike) : 208 orë totali në muaj = 9.6 punonjës elektrikist të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 1 muaji.

Duke qënë se punimet elektrike do të kryhen brenda 1 muaji (sipas grafikut të punimeve) njësia e prokurimit gjykon se këto punime mund të ecin paralelisht me punimet e tjera dhe mund të shtrihen në kohë, duke përgjysmuar numrin e nevojshëm të punonjësve elektrik si dhe duke iu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit të mësipërm.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se katër punonjës janë të mjaftueshëm për punime elektrike, duke përcaktuar 1 teknik të mesëm elektrik si dhe 3 elektrikist të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për elektrik, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Hidraulike 2 (dy)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet hidraulike do të kryhen në javën e pestë dhe të tetë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidraulik.

Konkretisht, vetëm për javën e pestë janë parashikuar punime hidraulike 65.98 orë punë nga zëri nr 40 deri 45 tek preventivi i punimeve (sipas tabelës nr 1).

Dhe nga zëri Nr 154 – 159 tek preventivi i punimeve (sipas tabelës nr 1) janë parashikuar rreth 113.9 orë pune.

Në total janë 179.88 orë pune për punime hidraulike.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet hidraulike janë 2 javë, atëherë duhen të kryhen në 104 orë pune

179.88 orë pune (për punimet hidraulike) : 104 orë totali për 2 javë = 1.7 punonjës hidraulik të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Duke qënë se punonjësit hidraulik shërbejnë edhe për punë të tjera si psh për kaldajen etj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër hidraulikë në përputhje me vëllimin e kontratës objekt prokurimi.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës hidraulik.

- **Specialist gipsi 3 (tre)** janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemeve të thata si realizimi i tavaneve me kartonxhes, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e gipsit, do të kryhen nga java e parë deri në javën e 11 (sipas grafikut të punimeve të cilësuar si punime ndërtimi) dmth gjithsej 2 muaj e gjys, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë gipsi.

Konkretisht, në zërin e preventivit seksioni III për punime suvatimi dhe veshje është parashikuar me nr anal 2.297/a Tavan me kartonxhes në sasinë 735 m², rreth 1543.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total janë 1543.5 orë pune për punime gipsi, si Tavan me kartonxhes.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

208 orë pune në total për një muaj x 2.5 muaj (që nevojiten këto punime të kryhen sipas grafikut të punimeve) = 520 orë punë (në dispozicioni për kryerjen e këtyre punimeve).

1543.5 orë pune (për punimet e gipsit) : 520 orë pune për 2.5 muaj = 2.96 punonjës Specialist gipsi të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të domosdoshëm punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist gipsi, duke garantuar autoritetit kontraktor që punimet e gipsit si psh Tavan me kartonxhes, të zbatohen me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) punonjës specialist gipsi.

- **Marangoz/Mobilier 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e vendosjes së dyerve të brendshme, strukturës së çatisë, dhe shiritit MDF në muret e klasave, sipas zërave të preventivit, tavani i drurit etj.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e drurit do të kryhen në javën e katërt dhe të pestë, dhe javën e tetë dhe të nëntë (sipas grafikut të punimeve) dmth gjithsej 1 muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë Marangoz ose Mobilier.

Konkretisht, në zërin e preventivit për punime shtresash është parashikuar me nr anal 2.276 Shtresë parketi druri në sasinë 120 m², rreth 564 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe në zërin e preventivit seksioni III për punime suvatimi dhe veshje është parashikuar me Analizë F + V shirit MDF në muret e klasave a=15cm, në lartësinë e bankave në sasinë 595 ml, rreth 595 orë pune të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe në zërin e preventivit seksioni VI për punime Çatie dhe Tarrace, është parashikuar me nr anal 2.279 Shtresë dërrasa FM 2.5cm në sasinë 150 m², rreth 240 orë pune të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total janë 1399 orë pune për punime të drurit, si parket, shirit MDF në muret e klasave dhe shtresë dërrase FM 2.5 cm.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet e drurit nuk janë të përcaktuar konkretisht në grafikun e punimeve për secilin zë, njësia e prokurimit gjykon se referuar orëve të punëve për këtë kategori që është relativisht e madhe dhe konkretisht 1399 orë pune dhe shtrirjen e tyre në kohë në 2 ose 3 muaj, nevojiten minimumi 2 (dy) punonjës për të garantuar zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

1399 orë pune (për punimet e drurit) : 624 orë totali për 3 muaj = 2.2 punonjës Marangoz ose Mobilier të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist Marangoz ose Mobilier, duke garantuar autoritetit kontraktor që punimet e drurit si psh punimet parket druri, shresë dërrasë FM 2.5 cm dhe shirit MDF në muret e klasave dhe shtresë dërrase FM 2.5 cm, të zbatohen me sukses.

- **Specialist asfalti 1 (një)** është i nevojshëm për punimet e hedhjes së shtresës asfaltike dhe binderit, përsa i përket sistemimeve të jashtme.
- **Specialiste për sisteme ngrohje-ftohje 2 (tre)** janë të nevojshëm pasi punimet e sistemit të ngrohjes zënë një pjesë të konsiderueshme në zërat e preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin ngrohje-ftohje do të kryhen në javën e katërt dhe të pestë, dhe javën e tetë dhe të nëntë (sipas grafikut të punimeve) dmth gjithsej 1 muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë për sisteme ngrohje-ftohje.

Konkretisht, vetëm për javën e katër dhe të pestë janë parashikuar punime ngrohje rreth 2902.8 orë punë nga zëri nr 94 deri 124 tek preventivi i punimeve (sipas tabelës nr 1).

Dhe nga zëri Nr 185 – 196 tek preventivi (sipas tabelës nr 1) janë parashikuar rreth 1172 orë pune.

Në total janë 4074.8 orë pune për punime ngrohje.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist për sisteme ngrohje-ftohje, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Edhe pse numri i orëve të punëve për punime ngrohje është relativisht i lartë, njësia e prokurimit argumenton se disponimi i një numri minimal prej 2 (dy) punonjësish nga ofertuesit, krijon bindjen dhe sigurinë e autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. AK është në të drejtën e tij të parashikoj kritere minimale kualifikuese.

- **Tekniku i Mesëm/Specialist Elektronik/IT** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve si instalimi i rrjetit të telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit dhe sistemin e survejimit me kamera, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Eskavatorist 1 (një)
- Automakinist 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores *“Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”*, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe datën e deshmise së aftësisë profesionale.*

****(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës (eskavatorist dhe automakinist) lejohet të plotësohet edhe nëpërmjet kontraktimit).***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 629 Datë 15.07 2015“Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të Tyre” (I ndryshuar).

Eskavatorist 1 (një) është i nevojshëm për punimet me eskavator dhe minieskavator ku përfshihen gërmimet sipas zërave të preventivit.

Automakinist 1 (një) është i nevojshëm për përdorimin e autovinçit, asfaltoshtueses etj, në përputhje me zërat e preventivit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

- 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësin e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga

shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësën e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

- 1 (një) përgatitës i konstruksioneve metalike, 2 (dy) Specialist Fasade, dhe 2 (dy) Karpentierë që të disponojnë çertifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të

licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe në V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Ky kriter është vendosur duke pasur parasysh natyrën e punimeve në lartësi referuar volumeve dhe natyrës së punimeve që parashikon projekti, meqënëse do të punohet për konstruksionet metalike, do te behet veshja e fasades me polisterol si edhe ndërtim çatie, dhe për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm të sigurisë.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

1 (nje) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas "Rregullores së sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehte" dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për specialistin punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar si me sipër, është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion, dhe Vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.

Kjo kërkesë është vendosur referuar kërkesave të parashikuara në projektin mekanik, ku përfshihet instalimi i rezervuarit të gazit, nxejja e ujit nëpërmjet kaldajes me gaz, dhe dërgimi i ujit të nxehtë nëpërmjet tubove multistrad në radiatorët e klasave përkatëse duke bërë ngrohjen e ambjentit. Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen dhe rëndësisë së objektit në të cilin do zbatohet kontrata, është e domosdoshme prania e **1 (një)** punonjësi të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë dhe **1 (një)** punonjësi të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG).

Qëllimi i autoritetit kontraktor nuk është vetëm ndërtimi i shkollës sipas standardeve bashkëkohore, por edhe siguria në ambjentet e saj. Duke qenë se në ambjentet e shkollës do të montohen pajisje të cilat në përputhje me bazën ligjore të sipërcituar kryhen nga persona të licencuar/trajnuar, garanton autoritetin kontraktor për montimin e tyre si dhe për sigurinë në shkollë, për sa kohë ky ambjent do të strehohet nxënësit, dhe ku siguria e tyre është primare për Bashkinë Kuçovë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i sipërcituar është hartuar në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e kontratës, duke garantuar AK për zbatimin e saj me sukses dhe në kohë.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) persona *për të paktën muajin e fundit.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve *për të paktën muajin e fundit*, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbeshtetes eshte llogaritur ne baze te volumeve dhe grafikut te punimeve.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 4 (katër) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmërinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar dmosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Njësia e prokurimit është bazuar në Manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre me Nr 629 datë 15.07.2015, ku ka përcaktuar orët e punës që do të kryhen për secilin zë të preventivit të punimeve në përputhje me afatin kohor të zbatimit të kontratës (sipas tabelës së mëposhtme.

TABELA NR 1

PËRLLOGARITJA E FUQISË PUNTORE SHKOLLA E MESME
"LLAZAR KULI"

Nr	Nr.An	PËRSHKRIMI PUNIMEVE	Njesi	Sasi	op/njesi	op x njesi
1		SHKOLLA EKZISTUESE			1 njesi	x njesi
2		1-PUNIME PRISHJE			op	o p
3	2.426/ 3	Prishje shtresa betoni dyshemeje t = 10 cm	m ³	85.0	18.8	1,598.0
4	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m ³	7.0	2.2	15.4
5	Anali ze	Prishje suvaje t=3-4 cm h=3.05 m , 3.15 m	m ²	2,450.0	0.8	1,960.0
6	Anali ze	Heqje dyer dritare	m ²	155.0	1.5	232.5
7	Anali ze	Cmontim - heqje ulluqesh horizontale e vertikale	ml	145.0	0.5	72.5
8	Anali ze	Heqje pllaka muri ne vertikalitet (nyjet sanitare)	m ²	55.0	1.2	66.0
9	Anali ze	Heqje pllaka ne dysheme	m ²	855.0	1.2	1,026.0
10	Anali ze	Prishje suvatim i jashtem t= 5cm	m ²	537.0	1.5	805.5
11	Anali ze	Heqje shtrese hidroizolim dhe nenshtresat + transport mbeturinash 5 km (tarraca)	m ²	437.0	1.75	764.8
12	Anali ze	Cmontim I rrjetit elektrik ekzistues	shum e	1.0	120	120.0
13	Anali ze	Cmontim I nyjeve hidrosanitare	shum e	1.0	16	16.0
14	2.37/5 b	Transport mbeturina ndertimi, dheu deri 10 km	m ³	154.5		-
15						
16		2-PUNIME NDERTIMI				
		I. PUNIME MURATURE				
17	2.64/1	Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3 m llac M-15	m ³	10.0	11	110.0
		II. PUNIME SHTRESASH				
18	2.262	Shtrese betoni C 6/10 t = 10 cm	m ³	85.0	8.6	731.0
A- 5.2	2.262/ 3	Shtrese betoni C 12/15 (parvazet e shkalleve,rampat e shkalleve dhe dritaret)	m ³	8.3	8.6	71.4
A- 5.3	2.195	Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum (kati perdhe)	m ²	437.0	0.4	183.5
A- 5.4	2.196/ c	Hidroizolim ne nyje sanitare me dy shtresa mapej	m ²	82.0	0.65	53.3
A- 5.5	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	m ²	855.0	0.66	564.3

19	2.267/1	Shtrese me pllaka grez porcelanato ne klasa, laboratore, zyra ngjitur me kolle	m ²	735.0	2	1,470.0
76	2.276	Shtrese parketi druri	m ²	120.0	4.7	564.0
29	2.273/4	Shtrese me pllake mermeri t=2cm Janina dritare+shkalle dhe sheshpushime	m ²	53.0	3.12	165.4
III. PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE						
20	2.326	Veshje me pllake majolike	m ²	82.0	3.7	303.40
21	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m ²	1,715.0	0.775	1,329.13
22	2.297/a	Tavan me kartonxhes	m ²	735.0	2.1	1,543.50
23	Analize	Veshje fasade me polisterol t=7cm zjarrdurues + rrjete + suva	m ²	537.0	5.8	3,114.60
24	2.308a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m ²	537.0	3.5	1,879.50
25	2.348	Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me çokitje	m ²	52.0	7.6	395.20
	2.324/2	Plintus me pllaka mermeri ne shkalle	ml	45.0	0.35	15.75
	2.324/b	Plintuse grez importi, h = 10 cm	ml	602.0	0.35	210.70
	Analize	F + V shirit MDF ne muret e klasave a=15cm, ne lartesine e bankave	ml	595.0	1	595.00
IV. PUNIME DRITARE DHE DYER						
26	2.375/1	Dritare duralumini plastike dopio xham	m ²	93.6	2.65	248.04
27	2.373/1	F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham	m ²	15.2	2.62	39.82
	2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a. (Tualetet)	m ²	9.2	2.4	22.08
28	2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I	m ²	34.0	0.68	23.12
	Analize	F V dyer emergjence me brave antipanik	cope	2.0	0.8	1.60
V. PUNIME BOJATISJE						
